

20160531358

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT SHTETËROR PËR VENDIMMARRJE NË SHKALLË TË DYTË NË SFERËN E MBIKËQYRJES INSPEKTUESE DHE PROCEDURËS PER KUNDËRVAJTJE

Neni 1

Në Ligjin për themelimin e Komisionit shtetëror për vendimmarrje në shkallë të dytë në sferën e mbikëqyrjes inspektuese dhe procedurës për kundërvajtje ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 130/14), në nenin 3 paragrafi (4) alineja 5 në pikën 4 presja zëvendësohet me lidhëzën "ose".

Në pikën 5 lidhëza "ose" zëvendësohet me lidhëzën "dhe".

Pika 6 shlyhet.

Në paragrafin (5) alineja 5 në pikën 4 presja zëvendësohet me lidhëzën "ose".

Në pikën 5 lidhëza "ose" zëvendësohet me lidhëzën "dhe".

Pika 6 shlyhet.

Neni 2

Në nenin 9 paragrafët (8), (9), (10), (11), (12), (13), (14), (15), (16), (17), (18), (19) dhe (20) shlyhen.

Neni 3

Pas nenit 9 shtohet nen i ri 9-a si vijon:

"Neni 9-a

(1) Komisioni Shtetëror është i detyruar që të autorizojë person - anëtar ose nëpunës administrativ për të udhëhequr procedurën për ankesën.

(2) Kur organi i shkallës së dytë vepron për ankesën e parashtruar kundër aktit administrativ i cili njëherë është anuluar dhe kthyer në rizgjidhje, personi i autorizuar zyrtar nga paragrafi (1) i këtij neni është i detyruar që në afat prej 10 ditësh nga dita e pranimit të ankesës të kërkojë nga organi i shkallës së parë t'i përcaktojë të gjitha faktet dhe t'i marrë dëshmitë në lidhje me lëndën, të nevojshme për zgjidhjen e tij.

(3) Personi i autorizuar zyrtar i organit të shkallës së parë është i detyruar që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni t'i konstatojë faktet e kërkuara dhe t'i marrë të gjitha dëshmitë në lidhje me lëndën, të nevojshëm për zgjidhjen e tij dhe për atë ta njoftojë Komisionin Shtetëror.

(4) Nëse personi i autorizuar zyrtar nga paragrafi (1) i këtij neni nuk ka njohuri profesionale për ndonjë fakt që është i rëndësishëm për zgjidhjen e lëndës, atë mund në afat prej 10 ditësh nga dita e pranimit të ankesës të caktojë ekspertizë ose person tjetër profesional për detyrën zyrtare ose me kërkesë të palës.

(5) Eksperti ose personi tjetër profesional nga paragrafi (4) i këtij neni është i detyruar që ta përpilojë dhe ta dorëzojë konstatimin e tij, përkatësisht mendimin profesional në afat prej 30 ditësh nga dita e përcaktimit të tij.

(6) Nëse ankesa e palës është në lidhje me kërkesën për realizimin e të drejtës dhe interesit juridik, që është e lidhur me lëshimin e aktit administrativ i cili nuk mund të zëvendësohet me aktin e Komisionit Shtetëror, ndërsa Komisioni Shtetëror duke vendosur për lëndën se kërkesa e palës është e bazuar është i detyruar që ta ngarkojë organin e shkallës së parë për ta lëshuar aktin e tillë, në afat jo më gjatë se shtatë ditë, me cekje të saktë të dispozitivit të aktit.

(7) Personi i autorizuar zyrtar nga organi i shkallës së parë është i detyruar që në afatin e përcaktuar në paragrafin (6) të këtij neni të veprojë pas ngarkimit të Komisionit Shtetëror."

Neni 4

Pas nenit 11 shtohet nen i ri 11-a si vijon:

"Neni 11-a

Gjobë në lartësi prej 25 deri në 50 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit të autorizuar zyrtar nga Komisioni Shtetëror nëse nuk kërkohet nga organi i shkallës së parë t'i përcaktojë të gjitha faktet në lidhje me lëndën, të nevojshme për zgjidhjen e të njëjtit në afatin e përcaktuar në nenin 9-a paragrafi (2) i këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 25 deri në 50 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit të autorizuar zyrtar nga organi i shkallës së parë nëse nuk i përcakton të gjitha faktet e për atë nuk e njofton Komisionin Shtetëror në afatin e përcaktuar në nenin 9-a paragrafi (3) i këtij ligji.“

Neni 5

Procedurat e filluara deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji do të përfundojnë në pajtim me ligjin sipas të cilit kanë filluar.

Neni 6

Dispozitat e neneve 2, 3 dhe 4 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen me fillimin e zbatimit të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative në pajtim me nenin 141 të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 124/15).

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".